



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1038/1 Prot.

Tiranë, më 08.04.2025

VENDIM

Nr. 44 datë 07.04.2025

PËR

**PJESËMARRJEN E UST SI PARTNER
NË KONFERENCËN E 10-TË NDËRKOMBËTARE BALLKANIKE
TË SHKENCAVE SPORTIVE ME FAKULTETIN E KULTURËS FIZIKE,
UNIVERSITETI I TETOVËS, REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**

Mbështetur në nenin 3 dhe 38 të Ligjit nr. 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë', si dhe në Vendimet e Rektoratit me nr. 29 datë 10/02/2025 dhe me nr. 41 datë 28/03/2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës **07/04/2025**,

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e Universitetit të Sporteve të Tiranës si **partner** në Konferencën e 10-të Ndërkombëtare Ballkanike të Shkencave Sportive me Fakultetin e Kulturës Fizike, Universiteti i Tetovës, e cila do të organizohet nga data **07-08 Maj 2025** në Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut.
2. Anëtarët e Bordit Shkencor përfaqësues të UST të kësaj konference janë si vijon:
 - **Dr. Orkida KOSTA** – Zv/Dekan Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes;
 - **Dr. Surven METOLLI** – Përgjegjës i Dëpartamentit të Shkencave të Lëvizjes në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit;
 - **Prof.Asc.Dr. Genta NALLBANI** – Përgjegjëse e Departamentit të Kineziologjisë në Fakultetin e Shkencave të Rehabilitimit;
 - **Dr. Entela NEZIRI** – staf kërkimor – shkencor në Institutin e Kërkimit Shkencor të Sportit.
3. Ky Vendim i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim në çështje zyrtar të institucionit.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi njësitë kryesore të UST.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT

Prof.Dr. AGRON KASA

